



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 11.7.2019

Lënda: Parashtrimet e Komisionerit Publik në seancën gjyqësore të datës 11.7.2019, për çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, z. Gentjan Osmani, konfirmuar në detyrë me vendimin nr. 61, datë 2.8.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me anë të vendimit nr. 61, datë 2.8.2018, ka konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit, z. Gentjan Osmani, aktualisht anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Ndaj këtij vendimi, bazuar në nenin B, pika 3, germa “c”, e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 65, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit (në vijim referuar ONM) ka paraqitur pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë “*Rekomandim për paraqitje ankimi*”.

Gjithashtu, nga ana e ONM-së është përcjellë edhe një denoncim i ardhur nga publiku, i cili, bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, ndër të tjera, parashtron fakte dhe rrethana, të cilat eventualisht, pas hetimit dhe vlerësimit të tyre nga Kolegji, mund të përbëjnë shkak ligjor për rivlerësimin edhe të të dyja kritereve të tjera, atë të figurës dhe të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

Komisioneri Publik, pas analizës tërësore të provave dhe akteve të administruara nga hetimi administrativ i Komisionit, çmon se vendimi nr. 61/2018 nuk është i drejtë dhe në pajtueshmëri me to, si dhe subjekti i rivlerësimit, z. Osmani nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të ardhurave të tij. Si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklaratimit të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, në referencë të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të aneksit të Kushtetutës, nenit 33, pika 5, germa “b” dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

I. VLERËSIMI I KOMISIONERIT PUBLIK

Subjekti i rivlerësimit, në zbatim të nenit D, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, më datë ***.1.2017, ka dorëzuar pranë ILDKPKI-së deklaratën e pasurisë “Vetting”. Nga krahasimi i kësaj deklarate me deklaratat periodike të pasurisë, referuar nenit 32, pika 5, e ligjit nr. 84/2016, ndër të tjera, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasurinë: **apartament banimi me sip. 96 m², blerë për shumën 82.000 euro, në janar 2017.**

1. Në deklaratën “Vetting” kjo pasuri deklarohet si e fituar me anë të kontratës noteriale të shitjes, e datës ***.1.2017 (me nr. *** rep., nr. *** kol.) dhe në bashkëpronësi me bashkëshorten.

- 1.1 Shpenzimet e arredimit për këtë pasuri deklarohen në vlerën 3.000.000 lekë, me burim nga kursimet e subjektit dhe të bashkëshortes së tij, nga paga dhe shpërblime të tjera.
- 1.2 **Burimi** i krijimit të pasurisë, pra çmimi i blerjes prej 82.000 euro, deklarohet gjendje në llogarinë pranë *** Bank, e krijuar nga shitja e një apartamenti të mëparshëm, me sip. 72 m², për 80.000 euro, sipas kontratës së shitjes e datës ***.12.2016 (nr. *** rep., nr. *** kol.), si dhe derdhja e shumës prej 2.000 euro pranë kësaj llogarie bankare, në datë ***.1.2017, me burim nga kursimet e subjektit dhe të bashkëshortes.
- 1.3 Në deklaratën “Vetting”, subjekti deklaron edhe burimin e krijimit të apartamentit me sip. 72 m², shitja e të cilit ka shërbyer si burim krijimi “i pasurisë Vetting”, apartamentit me sip. 96 m². Subjekti deklaron se ky apartament, pra ai me sip. 72 m² është fituar me anë të kontratës së shitblerjes e datës ***.9.2016 (nr. *** rep., nr. *** kol.) porositur fillimisht me Aktmarrëveshjen e datës ***.2.2009, për vlerën 67.680 euro. Nga kjo vlerë, subjekti deklaron se janë paguar vetëm 63.680 euro, pasi diferenca prej 4.000 euro është zbritur si penalitet kontraktor për dorëzimin me vonesë të apartamentit. Subjekti ka sqaruar gjithashtu se me aplikimin nr. ***, datë ***.10.2016, pranë ZVRPP-së Tiranë, ky apartament është vlerësuar në shumën 80.000 euro (ose 11.200.000 lekë).
- 1.4 **Si burim financiar të pagesës së shumës 63.680 euro**, subjekti ka deklaruar:
- (i) Të ardhurat nga paga në vite dhe shpërblime të tjera të subjektit dhe të bashkëshortes;
 - (ii) Një hua e shlyer tërësisht (20.000 euro); dhe
 - (iii) Dhurim nga prindërit e bashkëshortes, në shumën 1.500.000 lekë.
- 1.5 **Në DV 2009**, ndër të tjera, subjekti ka deklaruar se për apartamentin e banimit me sip. 72 m², për vitin 2009, ka paguar shumën 47.680 euro, për shkak të shtyrjes së punimeve.
- 1.6 **Si burim financiar të pagesës së shumës 47.680 euro**, subjekti ka deklaruar:
- (i) Të gjitha kursimet *cash* në vite, së bashku me bashkëshorten;
 - (ii) Një pjesë e huas prej 20.000 euro¹, sipas deklarimit të subjektit, nga kjo hua rezulton të jenë paguar 5.000 euro, pasi 15.000 euro subjekti i deklaroi *cash*, si të mbetura nga kontrata e huas;
 - (iii) Të gjitha të ardhurat nga dhurimi për bashkëshorten, në shumën 1.500.000 lekë².
- 1.7 Po në DV 2009, subjekti dhe personi i lidhur me të, bashkëshortja, kanë deklaruar:
- (i) *Cash*, në shumën 15.000 euro, të mbetura nga kontrata e huas;
 - (ii) Kursime në *cash* për vitin 2009, në shumën 1.400.000 lekë, nga paga dhe shpërblime të tjera nga marrëdhëniet e punës së subjektit dhe të bashkëshortes;
 - (iii) E kursyer si e ardhur nga dietat... shuma 500 euro;
 - (iv) Dhurimi i prindërve të bashkëshortes... në shumën 1.500.000 lekë;
 - (v) Kursime *cash* ndër vite të bashkëshortes para lidhjes së martesës, nga marrëdhëniet e punës si gjyqtare... deri në vitin 2009, në shumën 550.000 lekë.

¹ Në rubrikën e “Detyrimeve financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, të DV 2009, subjekti deklaron: “Kontratë huaje pa afat, në formë shkresore, me qëllim blerjen e një apartamenti banimi, e lidhur në datë ***.8.2009, për marrjen e një huaje në shumën 20.000 euro, me një interes vjetor prej 5%”.

² Personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit, ka deklaruar këtë shumë si dhurim të prindërve, si shkak i kontributit në familje.

- 1.8 **Në DV 2011**, subjekti deklaron se ka shlyer nga huaja shumën 7.000 euro. **Në DV 2012**, subjekti deklaron se ka shlyer nga huaja shumën 5.000 euro dhe në **DV 2013**, subjekti deklaron se ka shlyer nga huaja shumën 8.000 euro. Pra, në vitin 2013 subjekti rezulton të ketë shlyer plotësisht huan prej 20.000 euro.
- 1.9 **Në DV 2016**, subjekti deklaron lidhjen e kontratës përfundimtare për blerjen e apartamentit me sip. 72 m², datë ***.9.2016 (nr. *** rep., nr. *** kol.), dhe, sikurse parashtruan edhe më sipër, me aplikimin e tetorit 2016 pranë ZVRPP-së, ky apartament është rivlerësuar në shumën 80.000 euro (ose 11.200.000 lekë).
- 1.10 **Po në DV 2016** (dorëzuar në mars 2017), subjekti deklaron shitjen e këtij apartamenti me sip. 72 m², me anë të kontratës së datës ***.12.2016 (nr. *** rep., nr. *** kol.), për vlerën 80.000 euro.
2. Për sa më sipër, për të vlerësuar nëse pasuria e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur/të tjerë të lidhur me të, është krijuar me burime të ligjshme, referuar nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, nenit 30 dhe 32, pika 4, e ligjit nr. 84/2016, analiza në vijim dhe vlerësimi do jetë mbi burimin e krijimit të pasurisë/apartament me sip. 72 m², për blerjen e të cilit janë deklaruar hua dhe dhurim³.
3. Si burim krijimi për blerjen e apartamentit me sip. 72 m², në DV 2009, subjekti ka deklaruar: (i) të gjitha kursimet *cash* në vite, së bashku me bashkëshorten; (ii) hua në shumën 20.000 euro, dhe (iii) dhurimin nga prindërit e bashkëshortes/personat e tjerë të lidhur, në shumën 1.500.000 lekë.
4. **Në lidhje me kursimet cash**, të akumuluarra deri në vitin 2009, sipas deklarimeve periodike të subjektit deri në këtë periudhë, rezulton se ato mbulohen nga të ardhurat me burime të ligjshme.
5. **Në lidhje me huan**. Referuar deklarimeve të subjektit rezulton se marrëdhënia e huas paraqitet e shtrirë në kohë prej gushtit të vitit 2009 dhe përfunduar, shlyer plotësisht, në vitin 2013. Kjo hua ka shërbyer për pagimin e kësteve për blerjen e apartamentit nga shoqëria ndërtuese “****” sh.p.k. Në këto kushte, hetimi administrativ i Komisionit është ndalur në: (i) burimin e ligjshëm të huas, referuar nenit 32, pika 1 dhe 32, pika 4, të ligjit nr. 84/2016; dhe (ii) mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit për të shlyer huan me të ardhura nga burime të ligjshme në tri këste, sikurse ka deklaruar ai vetë, për vitet 2011, 2012 dhe 2013, përkatësisht në shumat: 7.000 euro, 5.000 euro dhe 8.000 euro, së bashku me interesat.

5.1 **Mbi burimin e ligjshëm të huas**

- 5.1.1 Subjekti e ka deklaruar për herë të parë huan në DV 2009. Nga hetimi administrativ i Komisionit ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur asnjë dokument ligjor justifikues të kohës, i cili të vërtetojë dhe provojë marrëdhënien e huas, palët respektive apo mënyrën e marrjes dhe shlyerjes së saj. Për këtë arsye, në përgjigje të pyetësorit të Komisionit, të datës ***.4.2018, subjekti ka dhënë shpjegimet e tij.

³ Shitja e të cilit ka shërbyer më pas si burim për pasurinë/apartament me sip. 96 m², aktualisht në pronësi të subjektit dhe bashkëshortes së tij, deklaruar në deklaratën “Vetting”.

- 5.1.2 Bazuar në nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit i është kërkuar nga Komisioni të dokumentojë burimin e ligjshëm të të ardhurave të huadhënësit z. ***, në përgjigje të të cilit⁴, subjekti fillimisht ka paraqitur: dy kontrata pune të huadhënësit, datë ***.7.2002 dhe datë ***.2.2005, si dhe tri certifikata mbi të ardhurat e tij (huadhënësit), për vitet 2006, 2007 dhe 2008.
- 5.1.3 Duke qenë se dokumentet e mësipërme janë konsideruar të pamjaftueshme, Komisioni, në zbatim të nenit 52, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar **barrën e provës** subjektit për të dhënë argumente shoqëruar me provat shkresore, në lidhje me konstatimin mbi pamjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme të huadhënësit për të justifikuar huan e dhënë prej 20.000 euro.
- 5.1.4 Për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, subjekti ka paraqitur: leje qëndrimi, lëshuar më datë ***.1.1999; fletën e parë të pasaportës italiane të huadhënësit; dhe Certifikatën mbi të Ardhurat e Huadhënësit (CUD) për vitet 2002 - 2008.
- 5.1.5 Mbi bazën e akteve të mësipërme, trupi gjykues i Komisionit ka konkluduar se huadhënësi *“...nga viti 1999 e në vijim nuk ndodhet në Shqipëri, duke qëndruar në Itali. Në këtë shtet, ai ka realizuar të ardhura nga puna në shumën totale të 100.000 eurove. Në këto kushte, ai ka pasur mundësi për të kursyer shumën 20.000 euro, duke marrë në konsideratë dhe faktin se emigrantët nuk kanë një nivel të lartë jetese. Për sa më sipër, Komisioni krijon bindjen se z. ***,*** ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të kursyer shumën 20.000 euro”*.
- 5.1.6 **Komisioneri Publik**, ndryshe nga vlerësimi i Komisionit, çmon se subjekti i rivlerësimit dhe pas kalimit të barrës së provës, sërish nuk arrin të provojë të kundërtën.
- 5.1.7 Për huan e deklaruar, mungojnë aktet, dokumentacioni provues mbi mënyrën e marrjes dhe kthimit të saj, administrimi i kësaj shume (20.000 euro), nëse ato janë administruar në *cash* apo në llogari bankare dhe se si ato janë sjellë në Shqipëri, *cash* apo nëpërmjet kanalit bankar, me qëllim faktimin e mënyrës se si kjo shumë ka arritur te subjekti dhe si është shlyer prej tij.⁵ Kjo do të ishte e nevojshme me qëllim krijimin e bindjes mbi vërtetësinë e kësaj marrëdhënie huaje. Kjo marrëdhënie huaje, megjithëse është deklaruar prej vitit 2009, subjekti, me qëllim provueshmërinë dhe vërtetësinë e saj, ka paraqitur një shkresë të thjeshtë të datës *** gusht 2009, **vetëm pas kalimit të barrës së provës gjatë procesit të rivlerësimit**.
- 5.1.8 Në mungesë të këtyre fakteve, si dhe në referim të të dhënave zyrtare statistikore mbi nivelin e jetesës në shtetin italian, vlen të theksojmë se të ardhurat e ligjshme të realizuara nga personi tjetër i lidhur, ***,***, janë të mjaftueshme vetëm për mbulimin e nivelit minimal të shpenzimeve të jetesës së tij⁶, si dhe nuk rezultojnë e provuar aftësia financiare e huadhënësit për kursimin dhe dhënien e huas prej 20.000 euro, duke venë në pikëpyetje kështu burimin e krijimit të kësaj shume.

⁴ Referuar pyetësorit nr. *** të Komisionit.

⁵ Referuar dhe jurisprudencës së KPA-së, në vendimin (JR) nr. 12, datë 17.12.2018; vendimi (JR) nr. 6, datë 28.2.2019.

⁶ Bazuar në aktet dhe provat e paraqitura nga subjekti, deklaratat mbi të ardhurat e huadhënësit nga shteti italian (CUD), si dhe referuar të dhënave zyrtare nga: www.istat.it.

5.1.9 Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se, në kuptim të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 32, pika 4 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit dhe personi tjetër i lidhur me të, i deklaruar në cilësinë e huadhënësit, nuk arrijnë të vërtetojnë me anë të dokumentacionit justifikues ligjor burimin e ligjshëm të huas, sikundër nuk faktohet edhe ekzistenca e kësaj marrëdhënie.

6. Mbi mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit për të shlyer huan me të ardhura nga burime të ligjshme, në vitet 2011 – 2013

6.1 Nga analiza financiare e Komisionit ka rezultuar se për vitet 2011, 2012 dhe 2013, vite në të cilat deklarohet shlyerja e huas, përkatësisht në vlerat 7.000 euro, 5.000 euro dhe 8.000 euro, subjekti nuk mbulon me burime të ligjshme shpenzimet dhe shlyerjet e deklaruara në shumën totale prej - 2.498.919 lekë, fakt për të cilin subjekti i ka kaluar barra e provës.

6.2 Për të provuar të kundërtën, subjekti ka argumentuar rreth mënyrës së deklarimit të kursimeve në *cash* duke u shprehur se kur deklaron *cash*, nënkupton “*likuiditet/kursim brenda dhe jashtë sistemit bankar*”. Nën këtë argumentim, Komisioni ka konkluduar se “*subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të mjaftueshme për të shlyer huan në shumën 20.000 euro*”.

6.3 **Komisioneri Publik**, ndryshe nga përfundimi i Komisionit, vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën e barrës së provës. Konstatohet se Komisioni, duke mos vlerësuar drejt rrethanat dhe faktet e paraqitura nga subjekti, i ka marrë të mirëqena argumentet e tij, megjithëse shpjegimet dhe metodologjia e përdorur nga subjekti vjen në kundërshtim logjik me vetë deklaratimet periodike, ndër vite, të tij. Provat dhe argumentet e dhëna nga subjekti pas njoftimit për rezultatin e hetimeve dhe kalimit të barrës së provës, nuk i vlerësojmë si të mjaftueshme për të hedhur poshtë rezultatet e hetimit dhe për sa vetë subjekti ka deklaruar në vite⁷.

6.4 Nga analizimi i deklaratave vjetore rezulton se subjekti ka deklaruar ndër vite rregullisht kursimet në *cash*, në formularin ku kërkohet të deklarohen shtesat dhe pakësimet. Në DV 2009, subjekti ka deklaruar pakësim të kursimeve në momentin e blerjes së pasurisë apartament me sip. 72 m².

6.5 Komisioneri Publik, duke sjellë në vëmendje pikën II/12 të parashtrimeve të vetë subjektit gjatë hetimit administrativ të Komisionit, ku, ndër të tjera, për dhurimin e shumës 1.500.000 lekë nga prindërit e bashkëshortes shprehet se: ...“*shumë e cila... ka kaluar në formën e dhurimit, në dorë ose sipas gjuhës ekonomike ‘cash’, që posedohej në këtë mënyrë nga ana e tyre*”, vlerëson se nuk mund të vihet në diskutim kuptimi i fjalës “*cash*” prej subjektit.

6.6 Po ashtu, ligji nr. 9049/2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, në nenin 21 të tij, përcakton qartë se: “...*deklarimi i pasurive, i burimeve të tyre, i detyrimeve financiare bëhet sipas kërkesave të përcaktuara në këtë ligj dhe në formën e përcaktuar nga Inspektori i Përgjithshëm...*”. Formularët e deklarimit të interesave vjetore, miratuar nga Inspektori i Përgjithshëm, për vitet në të cilat subjekti argumenton mungesën e burimit të të ardhurave të ligjshme për të mbuluar

⁷ Referohu dhe jurisprudencës së KPA-së, vendimit (JR) nr. 7, datë 5.4.2019.

shpenzimet/kursimet e tij, përcaktojnë qartë se çfarë përfshihet në pasuritë e luajtshme, duke bërë në mënyrë të kuptueshme diferencën mes gjendjes *cash* dhe likuiditeteve në bankë.

6.7 Po ashtu, ky ligj në nenin 4, “*Afati dhe objekti i deklarimit*”, germa “d” e tij, përcakton qartë objektin e deklarimit, në të cilën është më se e kuptueshme se çfarë përfshihet në deklarimet *cash*. Pikërisht ky përcaktim i këtij ligji dhe ndryshimet e pësuar më pas saktësojnë diferencimin e objektit të deklarimit lidhur me gjendjen *cash*, jashtë sistemit bankar dhe likuiditeteve në bankë, depozita, në bono etj. Në analizën që subjekti ka vënë në dispozicion mbi perceptimin e konceptit të parave *cash*, rezulton se për disa vite, shumën e parave të poseduara në *cash* deklarohet në shumën të cilat, për nga natyra dhe për nga prerja zyrtare e monedhave, janë të pamundura për t’u disponuar fizikisht⁸.

6.8 Konstatohet gjithashtu se subjekti, ndryshe nga deklarimet e tij në deklaratat periodike vjetore, në qëndrimet e tij ndaj rezultateve të hetimit, ka deklaruar se: “*kursimi i deklaruar në fund të vitit në deklaratën periodike, në seksionin ku kërkohet të deklarohen shtesat apo pakësimet e pasurive, nuk është kursimi real i poseduar në fund të vitit të deklarimit, por në të janë përfshirë dhe pagesa të kryera gjatë vitit*”.

6.9 Këto mospërputhje të subjektit midis asaj çfarë ka deklaruar në deklarimet periodike vjetore dhe sqarimeve gjatë procesit të hetimit administrativ (vetëm pas kalimit të barrës së provës, pasi ka rezultuar me mungesë të burimeve të ligjshme për të mbuluar shpenzimet dhe kursimet e deklaruara), vlerësojmë se kanë për qëllim justifikimin e diferencave të konstatuara nga Komisioni në mbulimin e pasurive me të ardhura të ligjshme dhe nuk mund të shërbejnë për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, për sa kohë një gjë e tillë nuk është deklaruar në mënyrë të qartë dhe të plotë nga vetë subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike.⁹

6.10 Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka mbuluar me burime të ligjshme shlyerjen e huas së bashku me interesat ndaj personit tjetër të lidhur, shtetasit ***.***, për vitet 2011 - 2012 - 2013, minimalisht për një diferencë negative në shumën - 2.483.359 lekë¹⁰.

7. Në lidhje me shumën e dhuruar 1.500.000 lekë

7.1 Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar si burim për blerjen e apartamentit të banimit, me sip. 72 m,² edhe “*të gjitha të ardhurat nga dhurimi i prindërve, për bashkëshorten, në shumën 1.500.000 lekë*”, por për këtë fakt subjekti, edhe pas kalimit të barrës së provës, nuk paraqiti asnjë dokument financiar apo ligjor, përmes të cilit të vërtetojë marrjen e kësaj shume¹¹.

7.2 Për të provuar të kundërtën lidhur me ligjshmërinë e burimit të këtij dhurimi, subjekti ka vënë në dispozicion dokumente mbi të ardhurat e prindërve të bashkëshortes. Komisioni, pasi ka kryer analizën financiare mbi të ardhurat e familjes së bashkëshortes së subjektit, ka konkluduar se

⁸ Në analizën e vitit 2006, subjekti sqaron se kursimet në *cash* kanë qenë në vlerën 454.011 lekë. Në analizën e vitit 2007 sqaron se kursimet në *cash* kanë qenë në vlerën 499.926 lekë. Në analizën e vitit 2008 sqaron se kursimet në *cash* kanë qenë në vlerën 699.676 lekë dhe, po për këtë vit, deklaroi si kursime të bashkëshortes vlerën 499.426,13 lekë. Në analizën e vitit 2010 sqaron se kursimet në *cash* kanë qenë në vlerën 943.990,15 lekë. Në analizën e vitit 2011 sqaron se kursimet në *cash* kanë qenë në vlerën 88.837.49 lekë. Në analizën e vitit 2012 sqaron se kursimet në *cash* kanë qenë në vlerën 989.894 lekë.

⁹ Orientim ky i dhënë dhe nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, në vendimin (JR) nr. 7/2019.

¹⁰ Diferenca negative, respektivisht - 1.257.844 lekë, viti 2011; - 75.441 lekë, viti 2012 dhe - 1.150.074 lekë, viti 2013, pa përfshirë në këto llogaritje shlyerjen e interesave, në mungesë të deklarimit të subjektit.

¹¹ Referohu dhe vendimit (JR) nr.10/2018, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

personat e tjerë të lidhur, familjarët e saj kanë pasur të ardhura të ligjshme për të dhuruar shumën 1.500.000 lekë¹².

7.3 **Komisioneri Publik**, ndryshe nga përfundimi i arritur prej Komisionit, konstaton se dokumentacioni i paraqitur nga subjekti nuk sjell ndonjë ndryshim lidhur me rezultatet e hetimit administrativ, si rrjedhojë subjekti nuk ka arritur të provojë të kundërtën për sa i është kaluar barra e provës.

7.4 Në analizë të të ardhurave të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit dhe prindërve të saj për periudhën 2004 - 2008, mbështetur edhe në informacionin e vënë në dispozicion nga subjekti, rezulton se personat e tjerë të lidhur, prindërit e bashkëshortes së subjektit, nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme nga burime të ligjshme për të mbuluar gjithë shumën e deklaruar si të dhuruar¹³.

7.5 Sa më sipër, veç faktit se marrëdhënia e dhurimit është në nivel deklarativ, mbetet e pajustificuar dhe ligjshmëria e burimit të krijimit të kësaj shume të dhuruar.

8. Komisioneri Publik, nga rezultatet e analizës financiare, konstaton se, edhe nëse e marrim të mirëqenë huan e dhënë nga personi tjetër i lidhur, ***.***, si dhe dhurimin nga personat e tjerë të lidhur, prindërit e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, sërish subjekti nuk mbulon me të ardhura nga burime të ligjshme pagesat e kësteve për apartamentin, kryer në vitin 2009.

8.1 Lidhur me këtë fakt, rezulton se Komisioni, me shkresën nr. *** prot., datë ***.1.2018, ka kërkuar pranë shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k. informacion të detajuar mbi mënyrën dhe kështet e shlyerjes së apartamentit të blerë nga z. Osmani, shoqëruar me dokumentacionin përkatës. Shoqëria ndërtuese, në përgjigje të Komisionit, ka konfirmuar faktin se subjekti i rivlerësimit ka shlyer çmimin e apartamentit sipas 6 mandatpagesave (dërguar bashkëlidhur). Referuar këtyre mandatpagesave, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka shlyer çmimin total prej 63.680 eurosh, si më poshtë:

*i. Pagesë në arkën e shoqërisë 15.000 euro, datë ***.1.2009, sipas faturës nr. ***;*

*ii. Pagesë në arkë 32.680 euro, datë ***.3.2009, sipas faturës nr. ***;*

*iii. Pagesë në arkë 5.000 euro, datë ***.1.2010, sipas faturës nr. ***¹⁴;*

*iv. Pagesë në arkë 3.000 euro, datë ***.5.2010, sipas faturës nr. ***;*

*v. Pagesë në arkë 4.000 euro, datë ***.6.2010, sipas faturës nr. ***;*

*vi. Pagesë në arkë 4.000 euro, datë ***.7.2010, sipas faturës nr. ***.*

8.2 Sa më sipër, provohet se për vitin 2009 subjekti ka paguar dy këste, përkatësisht 15.000 euro, më datë ***.1.2009 dhe 32.680 euro, më datë ***.3.2009. **Pra, deri më datë ***.3.2009, rezulton se subjekti ka paguar shumën totale prej 47.680 euro (ose 6.579.840 lekë).**

8.3 Nga analiza financiare rezulton se subjekti dhe bashkëshortja e tij nuk mbulojnë me burime të ligjshme pagesat e kryera deri në mars të vitit 2009, duke përfshirë këtu dhe shumën prej 5.000

¹² Referohu f. 9 të vendimit të Komisionit.

¹³ Të ardhurat totale familjare janë në shumën 4.260.000 lekë, të përbëra nga të ardhurat e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit dhe babait të saj. Pasi zbriten shpenzimet e jetesës për 3 persona, për periudhën 2004-2008, si dhe kursimi i deklaruar i bashkëshortes së subjektit, në shumën 500.000 lekë, rezulton diferencë midis të ardhurave totale dhe shpenzimeve në shumën 1.260.581 lekë.

¹⁴ Mandati, në fakt, daton në ***.1.2009 dhe jo në 2010.

eurosh të huas së deklaruar prej tij, si të përdorur për shlyerjen e kësteve, si dhe dhurimin nga prindërit e bashkëshortes, me një diferencë negative prej - 1.041.185 lekë¹⁵.

8.4 Në këto kushte, Komisioneri Publik nuk i vlerëson bindëse shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës, ku shprehet se: *“1. Mandati i arkëtimit me nr. ***, datë ***.3.2009, është prerë në mënyrë të njëanshme nga përfaqësuesit e shoqërisë “***” sh.p.k., me qëllim për ta ndihmuar (subjektin), për të kryer pagesat në çdo kohë në arkë (arkëtimin e shumës), pa qenë e nevojshme prania e përfaqësuesve të shoqërisë”*. Pra, sikurse pretendohet nga subjekti, mandati i arkëtimit në vlerën 32.680 euro nuk është paguar i plotë më datë ***.3.2009, pasi nuk disponoheshin likuiditete të mjaftueshme në euro për këtë pagesë. Sipas pretendimit të subjektit, pagesa e plotë është bërë deri në muajin dhjetor 2009.

8.5 Në mbështetje të këtyre shpjegimeve, subjekti ka depozituar shkresën e shoqërisë “***” sh.p.k., e cila, në ndryshim nga sa i është përgjigjur Komisionit, në përgjigje të kërkesës së subjektit, ka deklaruar se: *“Bazuar në marrëdhëniet e mirëbesimit që ne kemi ndërtuar me njëritjetrin në lidhjen e kësaj aktmarrëveshjeje, pamundësinë tuaj fizike për të qenë prezent gjatë orëve të punës së administratës së firmës sonë dhe duke pasur në konsideratë parashikimet kontraktore të kontratës ***.2.2009, nga ana e shoqërisë është lejuar faturimi i shumës në mandatin e arkëtimit nr. ***, prej 32.680 eurosh (kësti më i madh), të shkruhet e plotë, realisht nga ana Juaj kjo shumë është arkëtuar deri në fund të vitit 2009”*.

8.6 Sikurse provohet, janë depozituar prova kontradiktore mbi kohën dhe vlerat e paguara nga subjekti i rivlerësimit për këtë pasuri në vitin 2009, pasi shkresat e shoqërisë së ndërtimit, të administruara nga Komisioni, në cilësinë e provës, kundërshtojnë njëra-tjetrën. Nga njëra anë, shoqëria ndërtuese pranon se ka arkëtuar shumën 32.680 euro, duke paraqitur për këtë qëllim mandatpagesën nr. ***, datë ***.3.2009, ndërkohë, pas kalimit të barrës së provës subjektit, në përgjigje të këtij të fundit, shoqëria e ndërtimit shprehet se kjo shumë nuk është shlyer në datë ***.3.2009, por është shlyer deri në fund të vitit 2009¹⁶.

8.7 **Komisioneri Publik** vlerëson se argumentet që paraqet shoqëria në përgjigje të subjektit të rivlerësimit mbeten të nivelit deklarativ dhe nuk shërbejnë për të vërtetuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në kuptim kjo edhe të nenit 49/4, të ligjit nr. 84/2016. Këto argumente të shoqërisë së ndërtimit, nisur nga pretendimi mbi pamundësinë fizike të subjektit, i vlerësojmë si jobindëse dhe nuk justifikojnë faktin se pse kjo shoqëri duhet të vërtetonte, nëpërmjet lëshimit dhe nënshkrimit të mandatpagesës nr. ***, datë ***.3.2009, shlyerjen e 32.680 eurosh nga ana e subjektit të rivlerësimit. Bazuar kjo edhe në parimet e kontabilitetit dhe vlerës provuese, që paraqet mandatpagesa në këtë rast, si dokumenti që vërteton hyrjet e likuiditeteve në arkën e shoqërisë në kohë reale, me qëllim regjistrimin në librat kontabël, vlerësojmë se shoqëria nuk ka pasur asnjë pengesë të arsyeshme e ligjore për prezantimin drejt të rrethanave dhe fakteve, duke provuar, me

¹⁵ Në analizë janë marrë në konsideratë shuma e kursimeve të akumuluar, të deklaruar nga subjekti dhe bashkëshortja deri në fund të vitit 2008, të ardhurat nga paga e subjektit dhe të bashkëshortes për periudhën janar - mars 2009, 5.000 euro nga huaja e deklaruar nga shtetasi ***, ***, si dhe dhurimi nga prindërit e bashkëshortes.

¹⁶ Dokumentuar nga subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit, datë ***.7.2018. Vlerësojmë se kontradiktorialiteti, si dhe koha kur është bërë kjo deklaratë, janë elemente të mjaftueshme që ajo të mos merrej në konsideratë nga trupi i Komisionit. Për më tepër në këtë drejtim, referohu vendimit (JR) nr. 10/2018, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

anë të mandatpagesave përkatëse, pretendimin se subjekti ka arkëtuar shumën jo në mars të 2009-ës, por deri në fund të vitit 2009.

8.8 Edhe nëse pranojmë argumentet e subjektit mbi shtyrjen në kohë të pagesës ndaj shoqërisë ndërtuese, ajo që rezulton edhe në këtë rast është se nga analiza financiare e të ardhurave dhe shpenzimeve për të gjithë vitin 2009, subjekti i rivlerësimit sërish nuk mbulon me të ardhura nga burime të ligjshme kursimin e deklaruar dhe pagesat e kryera.

8.9 Në DV 2009, subjekti, krahas blerjes së pasurisë apartament, ka deklaruar kursime nga pagat, në shumën 1.400.000 lekë dhe *cash*, në shumën 15.000 euro, të mbetura nga kontrata e huas¹⁷. Ndërkohë, në qëndrimet e tij lidhur me rezultatet e hetimit, subjekti sqaron se në total gjendja e likuiditeteve në datë ***.12.2009 ka qenë në shumën 364.642 lekë. Ky pretendim i subjektit mbi kursimin në *cash* të vitit 2009, përveçse nuk është në përputhje me përcaktimet e formularit të deklarimit, nuk është as në linjë provuese të njëjtë me deklarimet e mëparshme të subjektit të rivlerësimit.

8.10 Nga sa ka shpjeguar subjekti, rezulton se, në mars të vitit 2010 (periudhë kur është plotësuar DV 2009), nuk mund të deklarohet një kursim në *cash*, i cili është shpenzuar respektivisht në korrik dhe dhjetor të vitit 2009¹⁸. Gjithashtu, deklarimet e subjektit se shpenzimet për këtë periudhë kanë qenë më minimale se ato të llogaritura nga ana e Komisionit, i konsiderojmë në nivel deklarativ dhe të pambështetura.

8.11 Në konkluzion të sa më sipër, bazuar në analizën e të ardhurave dhe shpenzimeve të vitit 2009, edhe nëse marrim në konsideratë faktin se pagesa e apartamentit është bërë e shtrirë gjatë gjithë vitit 2009, rezulton se subjekti nuk mbulon me burime të ligjshme kursimet dhe shpenzimet e deklaruara gjatë këtij viti, për një diferencë negative prej - 764.483,44 lekë.

9 Pasuria e luajtshme, automjet tip “Golf 3”

9.1 Në deklaratën e interesave private të vitit 2009, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjithashtu edhe një automjet të tipit “Golf 3”, blerë në datë ***.7.2005, për vlerën 450.000 lekë, *cash*, si kursime nga marrëdhëniet e punës dhe shpërblime të tjera.

9.2 Në deklaratën e interesave private të vitit 2005, ky aset nuk rezulton i deklaruar, fakt për të cilin Komisioni e ka pyetur subjektin mbi arsyet e mosdeklarimit. Subjekti, në përgjigje të pyetësorit të datës ***.4.2018¹⁹, sqaron ndër të tjera se është menduar si i deklaruar në vitin 2005, por që është konstatuar gjatë deklarimeve të interesave private të vitit 2009, në kohën kur ka bërë deklarimet së bashku me bashkëshorten për pasuritë e disponuara veçmas. Gjithashtu, subjekti shprehet se, për sa i përket aktit të blerjes, nuk disponohet nga ana e tij, për shkak se i ka humbur. Edhe deklarimi i bërë në vitin 2009 është bërë duke u bazuar në mënyrë të përafërt.

9.3 Nga analiza financiare lidhur me mundësinë për blerjen e këtij automjeti, Komisionit i ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme, fakt për të cilin i ka kaluar barrën e provës.

¹⁷ Në seksionin ku kërkohet të përshkruhen hollësisht ndryshimet (shesat dhe pakësimet), për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri më *** dhjetor të vitit të deklarimit.

¹⁸ Sipas sqarimeve të subjektit, gjatë qëndrimit të tij mbi rezultatet e hetimit paraprak.

¹⁹ Referohu fashikullit “Pyetësorët”, në dosje të Komisionit.

9.4 Për të provuar të kundërtën²⁰, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: “Automjet tip ‘Golf 3’, në vlerën 450.000 lekë, fituar me kontratën e shitblerjes, datë ***.7.2005, nuk është blerë me kursimet nga paga e vitit 2005, por nga likuiditetet nga kursimet e vitit 2004, pra nga shuma 750.000 lekë. Nga kjo shumë kanë mbetur likuiditete nga të ardhurat e vitit 2004 në vlerën 750.000 - 450.000 - 300.000 lekë. Likuiditetet e krijuara dhe të deklaruara në shumën 400.000 lekë për vitin 2005 u përkasin të ardhurave të vitit 2005... Përfundimisht, pasuria e mbartur për vitin 2006 apo deri më datë ***.12.2005 përbëhet nga: likuiditete në masën 700.000 lekë; pasuri e luajtshme (makinë) në vlerën 450.000 lekë”.

9.5 Komisioni i ka konsideruar bindëse sqarimet e mësipërme të subjektit dhe në përfundim ka konkluduar se ai ka pasur burime të mjaftueshme për blerjen e automjetit.

9.6 **Komisioneri Publik** vlerëson se deklarimi i subjektit në analizën financiare të paraqitur për efekt mbulimi të shpenzimeve me të ardhura të ligjshme, nuk përputhet me deklarin vjetor të tij për vitin 2005, sipas së cilit, në faqen nr. 3 të formularit, ku kërkohet të deklarohet: *Përshkrim i hollësishëm i shtesave dhe pakësimeve në çdo lloj pasurie të paluajtshme dhe të luajtshme...*, subjekti ka deklaruar: gjendje *cash* 400.000 lekë, dhe nuk rezulton të ketë deklaruar pakësime të likuiditeteve të mëparshme. Bazuar në deklarinet vjetore të subjektit të rivlerësimit, konstatojmë se ai nuk ka kryer deklarin të saktë në vitin 2005, si dhe ka kryer deklarin të pamjaftueshëm, pasi nuk mbulon me burime të ligjshme kursimet dhe shpenzimin e kryer në vitin 2005, për blerjen e automjetit, në shumën - 235.761 lekë.

II. Kërkimi i ankimit

10 Shkaqet përcaktuese për të cilat Komisioneri Publik çmon se ky vendim i Komisionit nuk është i drejtë, qëndrojnë në vlerësimin se: (i) nuk provohet dhe vërtetohet ekzistenca e marrëdhënies së huas, si dhe mundësia financiare e personit tjetër të lidhur për të dhënë hua shumën 20.000 euro; (ii) nuk provohet dhe vërtetohet dhurimi në shumën prej 1.500.000 lekë, si dhe mundësia financiare e personave të tjerë të lidhur për të dhënë këtë shumë, si rrjedhim, subjekti nuk mbulon me të ardhura të ligjshme shlyerjen e kësteve të apartamentit të blerë në vitin 2009; (iii) edhe nëse huan dhe dhurimin i konsiderojmë në mesin e burimeve të ligjshme, nga analiza financiare, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh të ligjshme për shpenzimet dhe kursimet e deklaruara për vitet 2005 - 2013, ku përfshihet edhe shlyerja e huas, në shumën totale prej 3.760.305 lekë. Subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklarin të pamjaftueshëm për kontrollin e pasurisë, referuar nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016;

10.1 Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

10.2 Nisur nga fakti se Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtuar ankim ndaj vendimeve të Komisionit ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë

²⁰ Referohu përgjigjes në dosje të Komisionit, f. 8 të parashtrimeve të subjektit.

kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit, pa pasur mundësinë ai vetë, Komisioneri Publik, që të ketë akses në burimet e informacionit dhe të disponojë për marrjen e provave;

10.3 Kërkojmë që shkaqet e këtij ankimi, së bashku me denoncimin nga publiku, të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe, në zbatim të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 61, datë 2.8.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Gentjan Osmani.

KOMISIONERI PUBLIK

Darjel SINA